



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 91 Datë 26.10. 2008

Mbi

Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 85 % të aksioneve të ARMO Sh.a tek shoqëria e përbashkët ANIKA MERCURIA REFINERY ASSOCIATED OIL Sh.A

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Perpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.10.2008, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimi i datës 28 Gusht 2008, për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 85 % të aksioneve në shoqërinë ARMO SH.A, nga shoqëria e përbashkët Anika Mercuria Refinery Associated Oil (AMRA SH.A).

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe Përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve të shoqërisë ARMO SH.A nga Shoqëria e përbashkët AMRA SH.A është realizuar nëpërmjet kontratës të datës 22 Gusht 2008, nënshkruar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për palën shitëse dhe nga përfaqësuesit e Anika Mercuria Refinery Associated Oil (këtu e më poshtë AMRA Sh.A) për palën blerëse.

Shoqëria e përbashkët AMRA SH.A blen me anë të kësaj Kontrate 85% të aksioneve të shoqërisë ARMO SH.A dhe përfiton kështu kontroll të vetëm në formën e zëvendësimit të pronësisë nëpërmjet blerjes së shumicës së aksioneve.

Vlera e këtij transaksioni është 128.750.000 Euro ose 4.357.491 aksione me vlerë nominale 4.357.491.000 Lek dhe do të shlyhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 3, pika 1 dhe 2 të Kontratës për blerjen e aksioneve. Sipas nenit 3 të Kontratës Për Blerjen e Aksioneve, Blerësi do të paguajë Çmimin e Blerjes jo më vonë se 10 dita nga data e mbylljes së kontratës që nënkupton miratimin nga të gjitha autoritetet shtetërore.

Kontrata e shitjes së 85 për qind të aksioneve të ARMO, sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit “AMRA OIL, SH.A në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 10 të Kontratës së lidhur ndërmjet palëve më datë 22 Gusht 2008, është miratuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 9993 datë 18 Shtator 2008 “Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 85 për qind të aksioneve të ARMO SH.A-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit konsorciumit “Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises & Mercuria Energy Group”(“AMRA OIL, sha”). Ky ligj është dekretuar nga Presidenti i Republikës me numër dekreti 5901, të datës 01 Tetor 2008, dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Transaksioni i njoftuar paraqitet si përfitim kontrolli i drejtëpërdrejtë ku shoqëria ARMO SH.A do kontrollohet nga aksioneri mazhoritar AMRA SH.A, zotërues i 85% të kapitalit aksioner me të drejtë vote dhe aksioneri METE do të jetë zotërues i 15% të aksioneve.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b dhe 10/2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, është përfitim i kontrollit të vetëm.

II. Palët në transaksion

-ARMO SH.A, me aksioner të vetëm **Shtetin shqiptar përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**, (METE), në cilësinë e **Shitësit** të pjesës 85 % të kapitalit aksioner, ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit shqiptar për përpunimin, transportin dhe tregtimin e Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre, me një leje tregtimi për një periudhë 10-vjeçare. METE, është pronari dhe përfituesi i vetëm dhe i ligjshëm i kapitalit në shumën 5.126.461.000 Lekë e përbërë prej 5.126.461 aksione në shoqërinë “ARMO SH.A” me vlerë nominale për aksion 1 000 Lekë.

- Shoqëria e përbashkët Anika Mercuria Refinery Associated Oil (AMRA SH.A), në cilësinë e **Blerësit**, është shoqëri aksionere, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e rregjistruar më datë 2 Korrik 2008 në Rregjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit (QKR), me Nr. identifikimi K81902013T, me administrator zt. Rezart Taçi dhe me seli në adresën Blv “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake Nr 2, Ap.9/1. Kapitali i saj themeltar kap shumën prej 2.000.000 Lek, i ndarë në 2.000 aksione me vlerë nominale prej 1.000 Lekë.

Shoqëria e përbashkët AMRA OIL Sh.A përbëhet nga këto shoqëri:

- a. **Anika Enterprises SA**, një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit Zvicërian, e regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjenezës me Nr. 11277/2004 Ref. Nr. CH-660-9227004-1 fed. me datë 28 Shtator 2004, me seli në adresën Rue “San Loren”, 15-17 CH 1207, Gjenezë, Zvicër, përfaqësuar në transaksionin e blerjes nga zt. Rezart Taçi, i cili është dhe zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë. Kapitali aksioner i saj kap shumën 100.000 Euro i përbërë nga 100 aksione me vlerë nominale 1000 Euro secila. Shoqëria është aksioner dhe zotëron 70% të aksioneve të shoqërisë së përbashkët AMRA OIL SH.A ose 1400 aksione me vlerë 1.400.000 Lek.
- b. **Refinery Associated of Texas INC**, një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit të shtetit të Teksas-it, e regjistruar pranë Regjistrin Tregtar të Texasit me Nr. 76028500 me datë 22 Korrik 1985, me seli në adresën Michael J. Utts, 145 Landa Street, New Braunfels Texas 78130-7867, SHBA, e përfaqësuar nga zt. Joseph Nelton Desormeaux i cili është dhe aksioner i vetëm i shoqërisë. Shoqëria është aksioner dhe zotëron 20% të aksioneve të shoqërisë së përbashkët AMRA OIL SH.A ose 400 aksione me vlerë 400.000 Lek. Kapitali aksionar i saj kap shumën 1000 Dollarë i përbërë prej 100.000 aksione të përbashkëta pa vlerë nominale.
- c. **Mercuria Energy Group Limitet Cyprus**, një shoqëri e krijuar që në vitin 1993 sipas legjislacionit të Qipros, me seli në Grigori Afxentiou Akamia 2 Build Flat, Zyra 401, Larnaca, Qipro. E regjistruar në Regjistrin Komëtar në Nicosia, Qipro me dosje nr. HE145530. kapitali aksionar i shoqërisë është 45.000.00 USD. Veprimtaria tregtare e grupit manaxhohet nëpërmjet shoqërisë Mercuria Energy Group Holding SA, me seli në Gjenezë, Zvicër. Në këtë transaksion, Grupi përfaqësohet nga filiali i tij Mercuria Energy Trading B.V, një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit holandez, e regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Dhomës së Tregit të Hollandës me Nr. 30197318 më datë 13 Korrik 2004, me seli në Koningslaan 112 3583 Gv Ytrecht, Hollandë, e përfaqësuar nga zt. Cyrill Costes dhe /ose zt. Franck Blais. Shoqëria është aksioner dhe zotëron 10% të aksioneve të shoqërisë së përbashkët AMRA OIL SH.A ose 200 aksione me vlerë nominale 200.000 Lek. Kapitali aksionar i saj kap shumën 4.725.000 Euro.

III. Xhiro e ndërmarrjeve

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në transaksion në tregun ndërkombëtar për vitin 2007 është 3115 miliard lekë, e ndarë:

- a) Anika Enterprises SA: 56 168 892 CHF = 4.5 miliard lekë;
- b) Refinery Associated of Texas: 448 905 459 \$ = 40 miliard lekë.
- c) Mercuria Energy Trading BV: 33 858 846 403 \$ = 3 070 miliard lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm për vitin 2007, realizuar nga ARMO Sha, është: 14 miliard lekë.

IV. Tregu përkatës

IV. I. Tregu Përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Ky përkufizim përfshin dy komponentët e tregut përkatës:

- a. *tregu i produkteve dhe;*
- b. *tregu gjeografik.*

IV. I. a. Tregu Përkatës i Produktit

- ARMO Sha është e vetmja shoqëri që operon në një treg mjaft specifik sic është ai blerjes së naftës bruto të prodhuar në Shqipëri dhe përpunimit saj. Veprimtaria e saj është blerja dhe përpunimi i naftës bruto si dhe shitja me shumicë dhe pakicë e nënprodukteve të naftës bruto. Aktiviteti i tregtimit të produkteve të shoqërisë ARMO përfshin eksportin e tyre, kryesisht me vendet fqinjë, por është i kufizuar për t’u tregtuar kryesisht në vendet e Bashkimit Europian për shkak të përqindjes së lartë të sqfurit që kanë këto produkte.

•AMRA Oil Sh.A ushtron aktivitetet si vijon:

- Eksport-import të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbureve në përgjithësi;
- Përpunim, rafinim i naftës dhe nënprodukteve të saj;
- Shitje me pakicë të karburanteve të të gjitha llojeve;
- Blerjen, importimin, eksportimin, transportimin, edhe për llogari të të tretëve, depozitimin, përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikantëve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu edhe bitumet;
- Blerjen, shitjen, qeradhënie, ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme;
- Veprime të tjera si lëshimi i dorëzanive dhe i garancive të tjera.

IV. I. b. Tregu Përkatës Gjeografik

Shoqëria tregtare ARMO sha, veprimtarinë e përpunimit dhe të shitjes të naftës dhe të nënprodukteve të saj, e ushtron në disa rrethe e njësi të regjistruara sipas certifikatës së regjistrit tregtar në; Tiranë, Fier, Ballsh, Mallakastër, Shkodër, Durrës, Vlorë etj.. Shitja e produkteve të shoqërisë realizohet në të gjithë tregun shqiptar.

Për vlerësimin e këtij përqëndrimi dhe efektet që sjell në tregun e brendshëm, treg gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Analiza e Konkurrencës

Realizimi i këtij transaksioni pritet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në tregun shqiptar të naftës përsa i përket rafinimit të saj por edhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj. Pasojë e përqëndrimit është zhvillimi i shoqërisë ARMO SH.A si në aspektin e administrimit, menaxhimit dhe zhvillimit teknologjik. Nëpërmjet investimit synohet të arrihet edhe shfrytëzimi i burimeve ekzistuese apo të reja, rritja e cilësisë së produkteve të tregtuara dhe tregtimi i tyre me Markën e saj dhe me logon “Made in Albania”, përmirësimin e kushteve të punës, investimin për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në tre vitet e para etj..

Duke u zëvendësuar aksioneri shtet me atë privat, pritet një zhvillim dhe përmirësim teknologjik i kushteve të mjedisit për shkak të eksperiencës në këtë fushë të njërës prej shoqërive pjesëmarrëse në konsorcium dhe një zhvillim ekonomik shoqërisë ARMO SH.A për shkak të fuqisë financiare kryesisht të shoqërisë Mercuria Energy Holding.

Analiza e konkurrencës ndahet në dy pjesë: për produkte për të cilat nuk ka tregje të prekura mes Blerësit dhe ARMO-s dhe për tregje ku aksioneri kryesor dhe administratori i blerësit ka në zotërim shoqëri që aktualisht veprojnë në të njëjtin treg të produktit.

ARMO blen naftën bruto dhe pas përpunimit prodhon produktet Solar, Mazut, Koks, Bitumi i lëngëshëm, Hollues, Virxhina dhe Gazoil.

V.1 Për produktet që nuk ka tregje të prekura nga përqëndrimi

ARMO sh.a është aktualisht e vetmja ndërmarrje në treg për përpunimin e naftës dhe produktet **Solar, Mazuti, Koksi, Bitumi i lëngëshëm, Holluesi dhe Virxhina** të cilat nuk hidhen në treg nga shoqëritë e tjera që veprojnë në tregun e tregtimit me shumicë dhe/ose pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Edhe shoqëritë e palës blerëse nuk kanë tregje të njëjta ose të ngjashme me këto produkte, pra nuk kemi tregje të prekura si pasojë e përqëndrimit.

Si pasojë e përqëndrimit, Blerësi fiton të drejtën ekskluzive të prodhimit të këtyre produkteve duke patur fuqi të konsiderueshme tregu për produktet Solar, Mazuti, Koksi, Bitumi i lëngëshëm, Holluesi dhe Virxhina ndaj dhe sjellja e tij do të jetë nën monitorim të vazhdueshëm nga ana e Autoritetit të Konkurrencës sjellja e tij për shkak të monopolit (pozitës dominuese) që zotëron në tregjet përkatëse të këtyre produkteve.

V.2- Për produktet ku ka tregje të prekura indirekt nga përqëndrimi

Në kuptim të ligjit nr 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, respektivisht nenet 10-12 dhe kreu III i Kontrollit të Përqëndrimeve, Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar impaktin që mund të ketë ky përqëndrim në treg në kuptim të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të ndërmarrjeve në treg.

Mes shoqërive AMRA Sh.A dhe ARMO Sh.A në mënyrë direkte nuk ka tregje të prekura për shkak se AMRA Sh.A nuk është prezente para përqëndrimit në tregun shqiptar, por në mënyrë indirekte mund të konsiderojmë si tregje të prekura pasi njëri nga aksionerët i cili është edhe administratori i AMRA Sh.A zotëron një shoqëri që veprojnë në tregëtimin të kaburanteve.

I vetmi produkt i prodhuar nga ARMO ku ka tregje të prekura me shoqërinë e njërit prej aksionerëve të palës blerëse është Gazoili, që zë rreth 21% të prodhimit total të nënprodukteve të prodhuara nga shoqëria ARMO Sh.A. për vitin 2007.

Produkti Gazoil që përpunohet dhe tregtohet nga shoqëria Armo Sha është një produkt relativisht i zëvendësueshëm me diezelin e importuar (D1,D2) nga shoqëria Taci Oil (i cili është zotëruar indirekt prej 59.5%⁽¹⁾ i shoqërisë AMRA OIL sha) pra, kemi treg të prekur vetëm në tregun e shpërndarjes (tregtimit) të diezELIT (gazoilit). Shkalla e zëvendësueshmërisë nuk është e plotë për shkak të përmbajtjes së ndryshme të squfurit në gazolin e importit dhe atij të prodhuar në vend.

Megjithatë, edhe nëse i marrim në konsideratë pjesët e tregut të ARMO Sh.A dhe Taçi Oil International të kontrolluara nga i njëjti person, dhe llogaritet indeksi i përqëndrimit HHI, rezulton se shkalla e përqëndrimit të tregut pas përqëndrimit rritet por gjithësesi mbetet një treg mesatarisht i përqëndruar, pa kaluar në strukturën shumë të përqëndruar të tregut.

Për më tepër, struktura e tregut karakterizohet nga konkurrentë të tjerë të fortë me pjesë të konsiderueshme tregu si shoqëria Kastpetrol me një pjesë prej 17% të tregut, Europetrol SG me 12% të tregut, Viloil me 9.3% të tregut, Global Petroleum me 7% të tregut që janë konkurrentët kryesorë aktualë dhe në të ardhmen në tregun e hidrokarbureve.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të 85 % të kapitalit aksionar të ARMO SH.A nga AMRA SH.A, dhe nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të shoqërisë.

Gjithashtu, sipas nenit 8, pika 3 kontratës së shitjes së 85 për qind të aksioneve të ARMO, sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit “AMRA OIL, sha” dhe konsorciumit “Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises & Mercuria Energy Group”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, do të monitorojë në vazhdimësi në rast të ndryshimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e AMRA Sh.A.

¹ Pjesa prej 70% që zotëron z. Rezart TACI në paketën prej 85% të aksioneve të ARMO sha nëpërmjet zotërimit të 100 % të aksioneve të shoqërisë ANIKA.

Në bazë të Kontratës për blerjen e aksioneve anëtarët e shoqërisë së përbashkët AMRA Sha, mund të transferojnë aksionet e tyre çdo filiali të tyre me kusht që këta të fundit të bien dakort shprehimisht me shkrim për kushtet e kësaj Marreveshje. Në rast se filiali do të transferojnë aksionet palëve të treta në tërësi ose pjesërisht, shitësi (Shteti shqiptar, METE), ka të drejtën të shprehë miratimin e tij në lidhje me përfituesin e propozuar të transferimit kjo brenda periudhës 5-vjeçare pas hyrjes në fuqi të kontratës”. Dhe për rrjedhojë edhe Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 69 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” do të japë vlerësimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 85 % të kapitalit aksioner të ARMO Sh.A tek shoqëria e përbashkët AMRA SH.A.
2. T’i kërkojë palëve pjesëmarrëse në trasaksion që në rast të ndryshimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e AMRA - s midis aksionerëve dhe/ose palëve të treta, t’i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës për një vlerësim, përpara realizimit të trasaksionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush PERPALI

(_____)
Zv/Kryetar

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE